



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Tryeza e parë e rrumbullakët

„Fshirja e subjekteve joaktive sipas detyrës zyrtare– probleme në praktikë “

Në kuadër të projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ më 04 prill 2017 u mbajt tryeza e rrumbullakët me temë: Fshirja e subjekteve joaktive sipas detyrës zyrtare – probleme në praktikë,„. Në këtë diskutim, në të cilin morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, të Regjistrimit Qendror, të Drejtorisë për të Ardhura Publike, të Odave dhe palë të tjera të interesuara, u dhanë shumë shembuj të paqartësive dhe mospërputhjeve në zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe u dhanë rekomandime për ndryshime të mëtejshme dhe përmirësime të ligjeve.

U theksua edhe nevoja për transparencë më të madhe, si dhe rregullim preciz normativ të kushteve sipas të cilave zbatohet likuidimi, me theks të veçantë mbi mbrojtjen e të drejtave të partnerëve, aksionarëve dhe kreditorëve.



Ndër çështjet e diskutuara ishte edhe mënyra e njoftimit për fillimin e procedurës për fshirjen e subjekteve joaktive, respektivisht sa është mënyra ekzistuese e mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve. Është kërkuar ridefinimi i kushteve sipas të cilave Regjistri Qendror do të mund të fillojë procedurën për fshirjen e një subjekti joaktiv, si dhe definimin e kornizës normative lidhur me bazat për fillimin e procedurës së likuidimit të detyruar i cili për momentin nuk është i definuar me ligj.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.

Shkup, 04.04.2017